



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

**SHTOJCË PËR AFATIN E PROCEDURËS SË KONCENSIONIT
PËR PROJEKTIMIN, NDËRTIMIN, OPERIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE
TRANSFERIMIN E AEROPORTIT NDËRKOMBËTAR TË VLORËS (VIA)
PAS VENDIMIT TË KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK**

Autoriteti kontraktues, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në zbatim të vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 22/2021, datë 15.01.2021 me objekt: Modifikimi i dokumentave të procedurës së konkurrimit “E hapur” me objekt: Dhënie me koncesion/PPP për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës (VIA), REF-46571-12-19-2019 me vlerë të parashikuar 86.638.359 Euro (pa TVSH), përgatiti shtojcën me sqarimet teknike të kërkuara nga operatori ekonomik ankimues, në lidhje me përcaktimet në lidhje me kategorinë e aeroportit. Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin e tij nr 22/3/2021, ka vendosur të heqë pezullimin e procedurës së konkurrimit “E hapur” me objekt: Modifikimi i dokumentave të procedurës së konkurrimit “E hapur” me objekt: Dhënie me koncesion/PPP për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës (VIA). Në zbatim të këtij vendimi, Autoriteti Kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së konkurrimit dhe ndërmerr masën e shtyrjes së afatit të dorëzimit të ofertave, pasi me njoftimin e ri drejtuar operatorëve ekonomikë për sqarimet e bëra, operatorët duhet të marrin masat dhe të përgatiten për dokumentacionin e garës.

Kjo masë ndërmerret në mbështetje të ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat” të ndryshuar, ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Sa më sipër:

PIKA 4.2 AFATI PËR DORËZIMIN E OFERTAVE

ISHTE:

Brenda dhe jo me vonë se: Data: 23/12/2020 Ora: 12:00 Oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, [www .app.gov.al](http://www.app.gov.al)

BËHET:

Brenda dhe jo me vonë se: Data: 01/02/2021 Ora: 12:00 Oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, [www .app.gov.al](http://www.app.gov.al)

PIKA 5 Afati kohor për hapjen e ofertave:

ISHTE:

Brenda dhe jo me vonë se: Data: 23/12/2020 Ora: 12:00 Oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, [www .app.gov.al](http://www.app.gov.al)

BËHET:

Brenda dhe jo me vonë se: Data: 01/02/2021 Ora: 12:00 Vendi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me mjete elektronike. Informacioni që komunikohet gjatë hapjes publike të ofertave, qe paraqiten me mjete elektronike duhet t'i komunikohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar oferta, në bazë të kërkesës së tyre.